

**V E N D I M**  
**Nr. 158, datë 25.4.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 404, DATË 24.10.1991 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN E PERSONALITETEVE TË LARTA SHTETËRORE”, NE**  
**NDRYSHIMET PËRKATËSE, SI DHE PËR CAKTIMIN E DIETËS DITORE TË**  
**MINISTRAVE, ZËVENDËSMINISTRAVE DHE PERSONAVE TË TJERË, TË BARAZUAR**  
**ME TA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Pika 6 e vendimit nr.404, datë 24.10.1991 të Këshillit të Ministrave ndryshon si më poshtë vijon:

“6/1.Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, zëvendëskryetarët e Kuvendit dhe Zëvendëskryeministri, kur shkojnë me shërbim në njësitë territoriale administrative të vendit përfitojnë dietë ditore në masën 4 000 (katër mijë) lekë në ditë. Kur kthimi bëhet brenda ditës përfitojnë dietë për ushqim në masën 2 000 (dy mijë) lekë. Shpenzimet e fjetjes u paguhen në bazë të faturave përkatëse.

6/2. Ministrat dhe personat e tjerë të barazuar me ta, kur shkojnë me shërbim në njësitë territoriale administrative të vendit përfitojnë dietë ditore, në masën 3 000 (tre mijë) lekë. Kur kthimi bëhet brenda ditës përfitojnë dietë për ushqim në masën 1 000 (një mijë) lekë në ditë. Shpenzimet e fjetjes u paguhen në bazë të faturave përkatëse.

6/3. Ministrat dhe personat e tjerë, të barazuar me ta, të cilët nuk e kanë vendbanimin pranë qendrës së punës, përfitojnë dietë ditore në masën 3 000 (tre mijë) lekë në ditë por jo më shumë se 50 për qind të pagës mujore, ndërsa shpenzimet e fjetjes u paguhen në bazë të faturave përkatëse.

6/4. Zëvendësministrat dhe personat e tjerë, të bazuar me ta, kur shkojnë me shërbim në njësitë territoriale administrative të vendit përfitojnë dietë ditore në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë. Kur kthimi bëhet brenda ditës, përfitojnë dietë për ushqim në masën 1 000 (një mijë) lekë. Shpenzimet e fjetjes u paguhen në bazë të faturave përkatëse.

6/5. Ministrat dhe personat e tjerë, të barazuar me ta, të cilët nuk e kanë vendbanimin pranë qendrës së punës, nuk përfitojnë dietë ditore dhe fjetjeje për ditët e pushimit javor, të festave zyrtare, të lejes së zakonshme vjetore dhe për ditët që janë pranë vendbanimit të tyre.”.

2. Efektet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, shtrihen nga data 1 maj 2002 dhe shpenzimet përballohen nga buxhetet vjetore, të miratuara për institucionet përkatëse.

3. Vendimet nr.63. datë 11.2.1993; nr. 115, datë 13.3.1993; nr.351, datë 19.6.1995 dhe nr.621, datë 16.9.1996, të Këshillit të Ministrave shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**